

ESPERINOI I TË SHTUNIES

E nbë nesër të Pashkövet te jatëra ditë ata hëngrën nga drithët e atij dheu bukë, të gjeshurë pa brum të ngriðhur, e të ri t'atij viti. E posa çë ata haën nga ata drithë të dheut, i sosi atire manna, e të bijët e Israelit ngë patën nëmannë. E tek ai vit u ushkjen tuë ngrënë nga pemët e dheut të Kanaanit. E streksi se si ndodhej Josueu ndë anëzë te Jerihoit, ngrëjti sit e 'tij e pa një burrë shtuara me shpatën e helkjurë jasht te dora e 'tij: e Josueu ju kjas atij e i tha: Je ti nga t'a-nët a nga armikjët? Ai mori e i tha: U jam krie e ushtris e t'in'Zoti, jam e vinj nani. E Josueu i ra atij përmist te dheu, e ju fal e i tha: o Zot, çë urdhuron ti shërbëtorit t'ënt? E aì i tha Josueut: sglith këputsët e ndsiri nga këmbët t'ote: pse vendi ku je e rri ë i shejt. E Josueu bëri ashtu'.

ESPERINOI I TË SHTUNIES

Piesë nga TË DALËT XIII, 20-22; XIV, 1-31; XV, 1-19.

Të bijët e Israelit nga Sokothi u ngrënë e van'e shtruan tendët në Othom mbë buzë të shkretirës. E Perëndia i vej përpara, ditën me një shtillë miekullie, sa t'i mësoj dhromin, e natën me një shtillë zjarrmi, sa të kishën dritë: përpara gjithë popullit ngë u lips shtilla e miekullës ditën e shtilla e ziarmi natën. E in'Zot i foli Moiseut e i tha: fliti të bijëvet e Israelit e thuaji të këthenen prapa: le të vën tendët përpara atij fshati (Piharihoti) çë isht në mes të Magdolit e të dejtit n'wall të Beelsefonit: përpara këtire vendëve ti ke të shtrosh tendët te ana e dejtit. E Faraoni ka t'i that popullit e 'tij: këta bijë të Israelit janë të sbierrë ndë atë dhe: pse shkretira i ka mbillur brënda. U ka t'hanjë zëmëren e Faraonit: e ai do t'i ndiekënjet.

ESPERINOI I TË SHTUNIES

t'i ve prapa atire: e U ka t'jem lëvduar mbi Faraonin e mbi gjithë ushtrin e 'tij: e kanë të njohiën të gjithë Egjiptianët se U jam Zoti Perëndia: e ata bën ashtu!. E i kle rrëfier rregjit i Egjiptianëvet se populli i Israëlit kishë jikur: e zëmbra e Faraonit edhé të shërbëtorëvet e 'tij u ndërrua e u pruar kundra popullit, e ata thanë:çë kemi bër na kështu'?t'i lëjëm të vejën të bijët e Israëlit, të mos na shërbejën neve ? Andai Faraoni bë t'i vëjën kuéjt kjerrit e 'tij e mori me 'të popullin e 'tij. E mori gjasht kjint kjerre të sgledhurë e gjithë kalorin e Egjiptianëvet e krerët mbi të gjithë. E in'Zot thajti zëmbrën e Faraonit, rregjit t'Egjiptit e të shërbëtorëvet e 'tij e ai ndokji të bijët e Israëlit e i vate prapa. Por të bijët e Israëlit kishën dalë nga Egjipti mbë dorë të t'Lartit Perëndì. Egjiptianët

ESPERINOI I TË SHTUNIES

i ndokjën tue vatur prapa atire e i gjetët kur kishën shtruar tendët afér dejtit:edhé kuéjt dhe kjerret e Faraonit e kalorët e ushtria e 'tij ishën përparrë atij fshati(Piharihoti) n'ball të Beelsefonit. E Faraoni kjasej; e të bijët e Israëlit ,si ngrëjtin sit,pan Egjiptianët çë vëjën tendët atié prapa atire: e u dreruan fort të bijët e Israëlit e zun t'i thërrisiën t'in'Zoti.

E i thanë Moiseut. Mos ngë ishën varrenë Egjipt, e na holkje jashta, të vdisiën këtu te shkretira? Çë na bëre kështu' neve të diliëm nga Egjipti ? Ngë ishë këjo fiala çë na të bëjëm në Egjipt kur të thoshiëm: lena këtu' neve të shërbejëm egjiptianët:se për ne isht më mirë të shërbejën egjiptianët se të vdesiën te këjo shkretirë. E Moiseu i tha popullit:mos trëmbij:rrini e vërreni shpëtimin e Perëndis çë sot Aì ka t'ju bënjë: përqë Egjiptianët çë kini par sot

ju ngë kini t'ishihëni më pér gjithë-monë. In'Zot ka t'kuftonj pér ju, e ju kini të kjetij. E Perëndia i tha Moiseut:çë më thërrét mua ? Fliti të bijëvet e Israelit:le t'zën dhromin.

E ti ngre purtekën t'ënde e ndej dorën t'ënde mbi dejtin e ndaje 'ndish: e le t'shkojën të bijët e Israelit në mes të dejtit pér në dhe të term.

E shi' se u do t'thanj zëmbrën e Faraonit e të gjithë Egjiptianëvet, e ata ka t'hijën brënda dejtit prapa atireve. E dua të kem lëvdì mbi Faraonin e mbi gjithë ushtrin e 'tij e mbi kjerret e te kuéjt e 'tij. Ahierna ëngjëlli i Perëndis u ngre të nisej tue shkuar përpara ushtris e të bijëvet e Israelit e u vu të jitsëj përpara atireve :ashtu edhé duall shtilla e mje-gullës nga fakjëja e 'tire e u mba pra-

pa atire:e hiri pér në mes ushtris të Egjiptianëvet e të ushtris t'Israelit e u mba. E u bë mët'errët edhé bë dritë natën:pse te ana e egjiptianëvet njegulla ishë e mëterte, te ana e bijëvet t'Israelit ishë një dritë çë natën i dëftoj dhromin:njera ushtri ngë u përzie met'jatrën gjithë natën.

E Moiseu ndeјti dorën mbi dejtin : e in'Zot me një erë e fortë e mjesditës gjithë natën holkji dejtin e e bë të term dejtin:e ujët u nda 'n dish.

E hijtë të bijët e Israelit në mes të dejtit ndë të term:pse ujët e dejtit ishë si një mur te ana e dërejtë e si një mur tek e shtrëmbëra. Egjiptianët i ndokjën e hirën prapa atireve; e gjithë kuéjt e Faraonit e kjerret e kalorët në mes të dejtit.

E menatnet streksi mbë herë çë bën ndritçullë, se Perëndia në shtillë ziarimi e mjegullie shtu siun mbi ushtrin e Egjiptianëvet e e prishi ushtrin e 'tire. E i ndsori rrotët kjerrëvet

ESPERINOI I TË SHTUNIES

e i holkji me rrëmbim. E thanë Egjiptsianët: jikiëm nga fakjëja e Israelit, se Perëndia lufton për ata kundra neve. In'Zot i tha Moiseut: ndej dorën t'ënde mbi dejtin e le të ve te vendi ujët, e le të pështronjë Egjiptsianët, mbi kjerret e mbi kalorët. E Moiseu ndejti dorën mbi dejtin e ujët u pruar te vendi, kur ish'e gdihej dita: Egjiptsianët jikiën për në ujit: e in'Zot i rrëmbeu e i shtu në mes të dejtit. E ujët si vate te vendi pështroi kjerret e kalorët e gjithë ushtrin e Faraonit çë kishën hijtur brënda dejtit prapa: Israelit: e nga ata ngë e shkaptopi edhé një. Por të bijët e Israelit jetsën mbë dhe të term në mes të dejtit: e ujërat atireve ishën si një mur te ana e drejtë e si një mur te ana e shtrëmbërë. E tek ajo ditë Perëndia ruajti Israeliin nga duart e Egjiptsianëvet: e Israeli pa egjiptsianët të vdekurë mbë buzën e dejtit. E Israeli pa dorën e t'in'Zoti të madhe, atë që

ESPERINOI I TË SHTUNIES

bëri in'Zot Egjiptsianëvet: e populli ju trëmp t'in'Zoti e patën besë te Perëndia e te Moiseu shërbëtori i 'tij.

Ahierna Moiseu e të bijët e Israelit i könduan t'in'Zoti këtë kënkë tue thënë: Le t'i këndo jëm Perëndis: se u lëvdërim Aì me lëvdërim:shturi te dejti kalin e kalorin. Perëndia isht fukjia jine e kënka jine: se Aì kle mua shpëtini jin: Aì isht Perëndia jin e po dua t'e lëvdonj. Perëndia i prindit t'im isht Aì e u po dua t'e lartësonj. Zoti, tri-ni i fort ndë luftë. Perëndi isht émbri i 'tij. Ai shturi te dejti kjerret e Faraonit e ushtrin e atij: të sgledhuritë, të parët krieluftarë e atij faraoni i humbi Aì te dejti i kukjë. Ujërat e këthella i pështruan:ata humbën te fundi i dejtit si një gur. E dërejta jote, o Zot, u lëvdërua në mëndie: e dërejta jote o Zot, drëmoi armikjët. Edhe te madhëria jote e lartë Ti prishe gjithë ata çë vun ballë me Tij. Lëshove mbërin t'ënde:këjo i gjëlliti si një fill kashtie.

ESPERINOI I TË SHTUNIES

E në të frijturit e tërbimit t'ënt u nda ujët:u ngrëjtin lart suvalat stavaë, sa bashkë kjëndruan si një mur : ujërat e këthella van'e u ngulën në nes të dejtit. Armiku kishë thënë: u ka t'i ndjek;ka t'i arrënëj. Kam të ndanj të mbarën e 'tire, e do t'nglinj shpirtin t'in: u ka t'hélkj shpatën t'i me;dora jine ka t'i pörfaronjë.

Dërgove Ti,o Zot,frimën t'ënde e dejti i pështroi ata: humbën si plumbi te ujët të frikëshim. Kush ë si Ti,o Zot, ndër të fortit? Kush ë si Ti i lëvduashën në shejtëri? i famasëshim në lëvdi,tue bër mërakulla? Ndejte të drejtën t'ënde e dheu i përpijti. Me lipisin t'ënde i dëftove dhromin këtij pulli çë Ti shpërbleve;e me fukjìn t'ënde e kjelle mbë vend të shejtëris s'ate. Gjindet e gjegjën e u dreruan; ata çë jesiën te Filistea u dhëmbën, nos t'i zëjën atireve vendet. Ahierna u shkundën të Parët e Edhonit,e shpejt u smolën të Mëndëmit e Moabit:atire i

zu dridhma;u llavën gjithë ata çë jesiën ndë Hanaan. Frika e dreja i raft mbi 'ta me mëndien e krahut t'ënt, o Zot o Zot ; kjëndrofshin si gurë,mos u tundshin njera çë të shkofshit populli i jit,o Zot;njera të shkoft ki popull jiti,kuj Ti je i Zoti. Këlliti , o Zot, e vëri ndë mal të trazhgimit t'ënt, ndë vent ku Ti do t'i jesësh,ndë Shejtërore çë Ti ngrëjte me duart t'ote.

Perëndia ka të rregjëronjë gjithë monë e mbi motin edhe të t'jerë. Se hiri kaluar Faraoni te dejti me kjerret edhé kalorët,e mbi ata Perëndia i prori ujët e dejtit. Të bijët e Israelit shkuani në mes të dejtit,skur jitsiën mbi një dhe i term.

7. Piesë nga libri i Sofonis Profet III,8-15. In'Zot thot këto fialë:Rri e më prit,o Jerósolimë,te dita e të ngja-

llurit t'im pér deshmi; pse vullimi jim
isht ki, të mbëjidhen bashkë gjindet e
të më vijën rregjërat : dua derth mbi
ata gjithë mbërën e tërbimit t'im:se
nga ziarri i të nzehtit t'im ka t'jet
jostë gjithë jeta. Se ahierna dua mbi
popujit të ndërronj gluhen te jinìt e
'tire sa të thresiën gjithë émbrin e
t'in'Zoti, të shërbejën nën nji sgjedhe
të vetëme. Andei, ka lumet e Etiopis
kam të pres U, të vijën ata çë më luten:
të bijët e popullit t'im të shprishur
ka t'më bien dhuretit e 'tire. Tek ajo
ditë ti ngë ke të ngukjesh pér të gjithë
të bëmat t'ote, me të qilat po kërkove
të më ftesie; se ahierna dua të
ndsier pér më mes ngah ti shkarzimet e
madhështis t'ënde, e ngë do t'vetësh
tue u lëvduar madheshtare pér malin
t'im të shejt. E brënda tek ti ka të lë
një gjindezë të vapkë e të butë: e ata
ka t'jen ponistë paj t'émbrit e t'inë

Zoti. E nga Israeli ata çë kjëndrojën,
ngë do t'bëjën padrejtëri e ngë do të
thonë të kota:e nos t'u gjëndëshit te
goja e 'tire gluhe gënjeshtrie:përcë
ka t'kenë ata ku të kulotiën e ku të
prëhen, e ngë do t'jet edhé kusht t'i
trëmbënje. Gëzou fort, o e bija e
Sionit:ngrë zërin e lëvdò, o e bija e
Jerosolimës:ngushëllou e kënakju me
gjithë zëmbrën t'ënde, o e bija e Je-
rosolimës. Se in'Zot të ndsori'ngrahë-
shit gjikimet t'atë; të ka shpërbler
'nduarshit e armikjëvet: rregji i Is-
raelit, Perëndia, isht më mes t'tij:ti
ngë ke të shohësh më gjë të kekjë.

8. Piesë nga libri i tret i rregjëra-
vet.XVII,8-24. In'Zoti i foli Elis
e i tha: Ngreu e jets më Sareptë të
Sidhonis:shi' se atié u i kam urdhuru-
ar njëi gruaje të ve, të të japënjë
të ngrënë. E ai u ngrë e vate Sareptë:

e jerdhi mbë derë të kjitetit: e shi' se atié ishë një grua e ve çë mbëjid-hëj dru: e i thirri asaj prapa e i tha: nirmë tsa ujë te një lagjì sa t'pi. E ajo ish'e vëj të ja mirrëj:e Elia prapa i thirri:bënëmë hir,bierëmë edhé tsa bukë te dora jote. E i tha gruaja: rroft in'Zot Perëndia jit!si ngë kan u bukë,po kan vetëm sa një grusht melli ,e një pikë vaji te rrrogjeja:e shi' se u jam e mbëjeth di limishte,e hinj brënda e ka t'e bënj për mua e për t'im bir:të ham e pran të vdesiën. E asaj i tha Elia: bën zëmërë:jets e bën ashtu' si the.Por bën më parë një petëzë(të piekurë nën hirit) e n'e bie:për tij e-për t'ët bir bën pran:se kështu' t thot Perëndia i Israelit:poçeja me miell ngë ka të sosënjà e rrrogjeja me vaj ngë ka të menjë(të lisset),njëra te di ta kur in'Zot të na japënjà shiun mbi fakjen e dheut. E gruaja vate e bëri

422.

ashtu' si i tha Elia:e hëngri ai edhé ajo e i biri i'saj. E çë tek ajo ditë poçeja mielli ngë u jos e rrrogjeja vaji ngë sosi mbi fialën e t'in'Zoti çë tha për gojë të Elis. E streksi pran se u sëmur i biri i asaj gruaje,të zonjës e shpis,e sëmunda e 'tij ishë shumë e rëndë njera çë tek ai u lips fri ma. E gruaja i tha Elis:o njeriu i Perëndis çë kam u me tij ? Çë hire tek u të më kujtoje të ligat t'ime, e të më vdisëj diali jim? E gruas Elia i tha: Biér mua t'öt bir;e e mori nga gjiri i 'saj e e kjelli lart te dhoma ku ai jisëj e e vu glat mbi shtratin e 'tij. E Elia ngrëjti zërin tek in'Zot e thoshëj:Mieri u ! o Zot,ti je deshmuar e së ves,me kë u jam e jes,ti nani e ke helmuar akjë sa t'i vdisëj diali i 'saj. E frijti tri herë mbi dialthin e thriti tën'Zonë,e thoshëj: o Zot,Perëndia jim,le t'venjë pameta brënda shpirti i këtij diali. E u bë ashtu':in'Zot gje-gji zërin e Elis e u pruar tek ai dial

423 .

ESPERINOI I TË SHTUNIES

shpirti i 'tij:se thriti dialin e ungjall. Elia e mori nga dhona e 'tij e ja kjelli posht e ja dha së jëmës.

E Elia i tha:shih, se it bir ë i gjallë. E gruaja nisi e i tha:shi' se jam e njoh se ti je njeriu i Perëndis e fiala e t'in'Zoti te goja jote isht e vërtetë.

9. Piesë nga libri i Isaïs Profet. LXI,10-II,LXII,1-5.

Le të gjzonet tek in'Zot shpirti jim: se Aï më veshi me mëndilin e Shëndetines, e më pështolli me të veshurën hareje. Si njëi dhëndërri më vu kurorën, si një nuse më stolisi me bukurì.

E ashtu' si dheu bën të rritet luleja e 'tij, e si kopshti shtie të dajën farët e 'tija:ashtu' Perëndia do t'mëndë t'lehet drejtëria e gëzimi përpara gjithë gjindevet. Për Sionin u ngë dua të kjetem e për Jerosolimën u ngë dua t'e sos, njera çë të dalnjë Drejtëria jine, si një ill çë shkëlkjén, Shëndetia jime

ESPERINOI I TË SHTUNIES

si një dritë çë dhizet. Egjithë ka të shohiën Drejtërin t'ënde e gjithë rregjërat Lövdin t'ënde: e ka të thresiën Tij me një émbër të ri çë Perëndia ka t'i thet. E ti ka t'jesh një kurorë bukurie te dora e t'in'Zoti e një dia-dhemë rregjërie te dora e Perëndis t'ënt. E ngë ka t'jesh thritur më "e harruameja", e dheu jit ngë ka t'jet thënë më "shkretirë", pse kanë të t'hen tij "e dashura": se t'in'Zoti i pëlqeve, e se te dheu jit kanë t'jesiën, dhe ut t'ënt ka t'i thenë "e jesura".

E si vete e rri një dialë me një virgjörë, ashtu' kanë të jesiën tu bij me tij. Si dhëndërri ka gëzimin me nusen, ashtu' in'Zot ka të gjzonet mbi tij.

10. Piesë nga TË BËRIT XXII,1-18.

Posa çë shkuan këto çë kemi thënë, streksi se Perëndia deshi të ngisëj Abramin e i tha atij:Abraam, Abraam.

E aï tha:gjegjëm. E in'Zot i tha: mirr t'ët bit, të vetëmin, Isakun çë ti

do mirë,e jets mbi atë dhe të lart:e atié ke t'm'e falësh mua,për flijë gjithëtë diegurë,mbi një mal çë u kam të t'e thom. Andai Abrami,të bërit ndritçullë,njize u ngre,nglakoi gomarin e 'tij e mori me 'të di vetë nga shërbëtorët e 'tij ,edhë Isakun të birin e 'tij:çajti drut për flijën gjithëtëdjequrshmen,u ngre e vate:e jerdi te vendi çë in'Zot i kishë thënë.

Tek e treta ditë Abrami ngfëjti sit e 'n së largu pa atë vent. E i tha Abramë shërbëtorëvet e 'tij:ju rrini këtu' me gomarin:u e dialthi do të vemi njera këtié,e posa çë kemi bër të luturat,do t'kthehemë tek ju. Mori pradrut për flijën,e ja vu ngrahë Isakut të birit t'tij; e mori te duart ziarrin edhë thikën e të di bashkë zun të jitsiën. Isaku i tha Abramit,të Jatit:Tate. E ai tha:çë isht , bir? E tha:shi' ziarrin edhë drut,e ku isht kjen kji për flijën çë ka t'djegiëm? E Abrami i tha:Perëndia për 'të do t'shohë-

një t'e gjenjë kjenkjin për të diegur, o bir.E vejën të di bashkë e jerdhën te vendi çë i kishë thënë Perëndia.

E ndërtoi atié Abrami theroren e sipër i vu drut:e lidhi Isakun të birin e 'tij , e e vu mbi theroren,atié sipër mbi drut. E ndejeti dorën e 'tij Abrami të mirrëj thikën të therëj birin e 'tij.

E një ëngjëll i t'in'Zoti nga kjiellia e thriti e i tha:Abraam,Abraam. E ai tha: gjegjëm. E i tha ëngjëlli:mos ndej dorën mbi dialthin,mos i bën gjë atij, se nani njoha, se ti i trëmbe Perëndis e për mua ngë kurseve birin t'ënt të dashurin. E Abrami,të ngrëjturit sit , pa një dash në mes të drizavet ,të mbajtur për brish. E Abrami vate mori dashin e ja fali Perëndis për flijë tue ja djegur gjithë në vend t'Isakut birit t'tij. E Abrami vendin e thriti: "Zoti ka t'e shohënjë":sa thonë edhë sot:"te mali Perëndia do t'e shohënjë".

E Ëngjëlli i t'in'Zoti nga kjiellia nj'etërë herë e thriti,tue thënë:U bëra be mbë vetëhén t'ime,thot Perëndia,se ti bëre këtë të thënë,e ngë kur-seve pér mua t'ët bir,të dashurin: andai tue bekuar du të t'bekonjë e tue shumësuar dua të bënj të rritet shumë fara jote,sa ijëzit e kjielliës e sa rrëra më buzë të dejtit e fara jote ka të trazhgjoni kjitetet e armikjëvet.

E te fara jote ka t'jen bekuar gjithë gjindet e dheut,përse ti më ke gjegjur zërin t'im.

11. Piesë nga libri i Isaïs Profet

LXI,1-10. Shpirti i Zotit Perëndi ë mbi mua: përsé mua më liejti Perëndia, sa t'i thom të vapkjëvet vangjejin; dërgoi mua,sa t'i jap kujdés atire me zëmbërë të prerë,sa t'i ligjëronj sh-klavëravet ndëjésën,e të verbëravet të

shohiën:sa të thres vitin e pakjies tek in'Zot;ditën e shpërbllimit,sa t' përgëzonj gjithë ata çë klan: sa këtire të Sionit çë janë në lip t'i jap U lëvdì e jo hi , vaj gjëzimi atire në lip,mëndil lëvdie e jo shpirt helmi: e ka t'jenë thritur liset e drejtëris, bima të Perëndis pér të lëvduar Mua.

E ata kanë të ndërtojën vendet të shkretë çë mot:kanë t'i ngjalliën ata vende të harruamë të të motçmëvet:ka të përtrijën kjitetet lënë të vetëmë çë mot nga jinit e shkuame. E kanë të vijën të huajit tue kuhotur delet t'uaja , e të bijët e 'tire do t'jen bulkjit e vreshtavet t'aj. Ju ka t'jini thritur Priftëria e tin'Zoti,të dhënët në shërbim të Perëndis:do t'hani nga të pasurat e gjindevet e do t'jini të lëvduashmë mbë lëvdì të 'tire.

Për dhunën di herësh e mbarrien do të

ESPERINOI I TË SHTUNIES

gëzonen mbi piesën e 'tire:se ashtu' te dheu i 'tire do t'ken pér di piesë; e gëzimi atire ka t'i jet gjithë monë mbi kriet e 'tire. Përsé U jam Perëndia çë dua mirë drejtërin e dua kekjë gra-bit të falura mua pér flijë: e të drejtëvet ka t'i paguanj brengën e vepravet e 'tire tek e vërteta: e dua të bënj me 'ta dhiatë të pasosme. E ka të jet njohurë ndër gjindet fara e 'tire, e në mes të popujvet nipérat e 'tire.

Kush i sheh do t'i njohënë: se këta janë fara e bekuame nga Perëndia, e ndëgëzië do t'jen gëzuar tek in'Zot.

12. Piesë nga libri i 4. i rregjera-vet. IV, 8-37.

Një ditë streksi se Eliseu ish'e shkoj pér në horës të Sumanit:e atié i-shë një grua e madhe e e mbajti të haj bukë. E disa herë i ngisëj të shkoj atéi e ai mbahej atié të haj bukë.

430.

ESPERINOI I TË SHTUNIES

E i tha gruaja burrit e 'saj: pa shih, kam njohur se isht një i shejt ki njeri i Perëndis çë shkon këtu' disa herë tek na. Pa do t'i bëjëm një dhomë, një vend të vogël, e i vum atié një shtrat, një triesë, një thron e një hërnar: e kur i nget të shkonjë tek na, vete e rri atié.

E jerdhi një ditë se ai hiri atié, e vate e rrijti tek ajo dhomë e atié u prë. E i tha Gjezat shërbëtorit t'tij: thritëmë këtë grua Sumanitë. E ai ja thriti:e ajo vate e u mba pérpara atij.

Eliseu i tha Gjezit: thuaji nani ti asaj:shi', ti ke pasyr pér ne gjithë këtë kujdes, çë mënd't'bënj u pér tij?

Në edhë isht të flitet pér tij rregjit a kries e ushtris. E ajo tha: u rrонj në mes të popullit t'im te shpia në pakjie. E i tha Gjezit Eliseu: çë do t'bënet pér këtë grua? e i tha Gjezi: E çë? ajo ngë ka edhë bij e burri i 'saj e plak. E i tha Eliseu: thrite. E Gjezi e thriti e ajo u mba pérpara derës: E i tha Eliseu asaj:mbë këtë mot, si te këjò herë, ti të rrosh, e ka t'kesh një bir.

431.

ESPERINOI I TË SHTUNIES

E ajo i tha: mos më gënjjé, o zoft, mua shërbëtoren t'ende. E ajo grua pati, e ju le një bir tek ai mot, tek ajo hëre si i kishë thënë asaj Eliseu. E diali ju rrit: e streksi një ditë se dolli të gjej të jatin tek ata çë kuariën.

E i tha të jatit: kriet! më dhëmbë kriet! E i jati i tha njëi shërbëtori: kjelle tek e jëma. E ai e kjelli tek e jëma. E ajo e mbajti dialin mbi glunjët njera pér miesditë: e diali i vdkjë. E jëma e mori e e kjelli lart e vate e vuri mbi shtratin e njeriut të Perëndis: e mbilli brënda e dolli. E thriti burrin e 'saj e i tha: dërgomë një nga shërbëtorët e një nga gomarët, sa u rrieth vete njera te njeriu i Perëndis e prem. E ai tha:përcë ti do t'vetësh sot tek ai? Ngë janë të parat ditë e moit, ngë isht e shtunia. E ajo u përgjeqjë: maren e i tha shërbëtorit e 'saj:eja, jits, mos më mbaj dhromit:bën çë të thom. E mori të jitsëj e jerdhi njera te një-

ESPERINOI I TË SHTUNIES

riu i Perëndis mbi malin e Karmelit.

E Eliseu, të parit se ajo vej, i tha s shërbëtorit e 'tij:shi', ajo grua e Sumanzi. Rrith nani e jetsi pérpara e t'i thuash: ke pakje? je mirë? ti e burri i jit edhé diali? E ajo i tha:mirë në pakjë. E arrënët çë arru te mali pérpara Eliseut ju shtu te këmbët e 'tija.

E Gjezi ju kjas sa t'e mbaj largu atij. Por njeriu i Perëndis, Eliseu i tha:le se shpirti i 'saj isht në helm, e Perëndia m'e fshehu këtë shërbes e ngë m'e bë t'e dija. Ajo i tha: Mos u lipa Zottit një bir? Ngë të thash:mos më kjeshë?

E Eliseu i tha Gjezit:lith mesin, mirr shkopin t'im te dora jote e jets shpejt: se në përpisk dhromit ndo njeri, mos u mba t'i falesh e në të falet ndo njeri, mos u përgjekjë: e vete e i vu shkopin t'im mbi fakjen e dialit. E i tha e jëma e dialit:rroft Zoti e rroft shpirti i jit, në u dua të lë tij. E Eliseu u ngre e vete prapa asaj. E Gjezi i shkoi pérpara asaj e vete e i vuri shkopin

mbi fakjen e dialit:e aì ngë kishë fri-më e ngë ndiejti gjë. E Gjezi u pruar e i duall pérpara Eliseut tue thënë: ngë u ngjall diali. Eliseu hiri te sh-pia e pa dialin të vdekur glat mbi sh-tratin e 'tij. E hiri te shpia e u mbill-brënda me dialim e zu t'i lutej Perëndis. U ngjip mbi shtrat e u shtrua mbi dialin:gojën e 'tij mbi gojën e atij; sit e 'tij mbi sit e atij e duart e 'tija mbi duart e atija,e i frijti e u përmis mbi atë,e mishët e dialit u ngroh. Elizeu pra u ngre e zu të jit-sëj pér në shpis atéi e kötei e pame-ta u ngjip e u nde mbi dialin: e diali shtu gogësimë e hapi gojën shtatë herë e sballi sit. Eliseu i thriti Gjezit e i tha: thrit gruan Sumanite, e e thriti e ajo jerdhi e hiri tek aì. E i tha Eliseu: mirr dialin t'ënt. Ajo ju shtu te kömbët e ju fal njera te dheu:e mori dialin e 'saj e dolli. E Eliseu mori e vate në Galgalë.

13. Piesë nga libri i Isais Profet LXIII,11-19;LXIV,1-5. Këto fialë thot in'Zot:kku isht Aì çë tolkji nga dejti delmerin me delet e 'tija ? Ku isht Aì çë vu:në mes t'atire shpirtin e shejtë-ris s'Tij? Ai çë kjelli Moiseun me të drejten e 'tij ? krahu i lëvdís s'tij ? Aì ndajti pérpara atireve ujërat,tus lënë pér'të një nomë të pasosme. Aì çë i kjelli pér dorie pér në hone,si një kal pér në shkretirë e ata ngë u lodhën të ndakuarë, e si kafsha pér në fushë, u sdrip shpirti i Perëndis e i kjelli ata:kështu ti solle popullin t'ënt tue bër pér tij një nomë lëvdie.
Priru nga kjiellia e vërrej nga shpia e Shejtëris t'ënde edhé të lëvdís t'ënde:ku isht të nzehtit t'at,fukjia jote ? ku isht lipisia jote e madhe e të kjel-merisurit t'at ? pse u ke mbajtur me ne? Por ti je Ati i jinë,se Abrami ngë

na njohu e Israeli ngë na di kush jemi: por ti,o Zot,je Ati i jinë,Shpërblesi jinë :çë më parë émbri jit ë kë mbi ne. Çë na le të rrachiëm së largu nga udhët t'ote: na thajte zëmbrat t'ona,sa mos të trëmbeshim Tij ? Priru mbi ne paj të shërbëtorëvet t'atë,paj të farës e trazhgimit t'ënt;se për pak mot na patëm malin e shejtëris t'ënde: armikjët na kanë shkelur Shejtoren t'ënde . Na ndodhemi nanë si më para,kur ngë ishe i zot mbi ne e kur na ngë thrisiëm émbrin t'ënt mbi ne. Në sblillie kjielliën e vije Ti këtu'ki't'dridheshën malet e ki't'joseshën përpara Tij:si dillët joset përpara ziarrit, armikjët ka t'jen diegur ka ziarri e embri i jit ka t'jet i njohur ndër armikjët. Përpara fakjies t'ënde gjindet kanë të tërbonen,kur të bësh këtë të lëvduashme:malet do t'i marrënë dridh-
436.

ma.

Çë mot e jetë kurr na kemi gjegjur,as sit t'anë kanë par perëndì t'jerë veç TIJ,e veprat t'ote çë do t'bësh atireve çë janë e presiën ndëjésë. Përsé do të i dalnjë përpëra atireve çë e presiën e çë bëjën të drejtën: e ata do t'kujtonen nga udhët t'ote.

14. Piesë nga libri i Jeremis Profet XXXI,31-34. Këto fialë thot in'Zot: shi' se vijën ditët., e U dua të bënj një dhiatë të re me shpin e Israelit e me shpin e Judhës. Jo si dhiatën çë bëra me tatërat e 'tire tek ajo ditë, kur i zura për dorie sa t'i tilkjëja nga dheu i Egjiptit,se ata ngë u mbajtën tedhiata jime e U i lëreva pa kujdes,thot in'Zot. Se këjo isht dhiata jime çë U do t'bënj me shpin e Israelit,të shkuarit ato ditë,thot in'Zot:
Dua t'i jap me-hir ligjën t'ime te

mendia e 'tire e dua t'ja shkruanj te zëmbra e 'tire e ka t'i jem atireve U Perëndia e ata kanë të më jen popull jimi. E ngë ka t'mësojën më nga-një shokun e 'tij e nga-një vëllaun e 'tij, tue thënë: njihëni Perëndin; se të gjithë kanë të më njohiën Mua çë nga më i vogëli njera te më i madhi i 'tire: se U dua t'i jem atireve i afër tue ndëjér padrejtërit e 'tire , e s'dua më të kujtonj mëkatët e 'tire .

15. Piesë nga libri i Danielit Profet III,1-88. Mbi tetëmbëdhietë vietë çë ishë rrekjë Nabukonodonosori bëri një statullë t'artë: e lartë trezëtë kute e gjerë gjashtë kute,e e vu shtuara te fusha e Durës ndë krahinë të Babilonës. E dërgoi të thënë sa të mbëjidheshën të gjithë bashkë:të Parët,krerat e ushtris,zotëronjësit e vendit,gjikjtarët,

kaptenjët,ligjëtarët,Plekjët,zotërit e mëdha ndë pushtetie e gjithë urdhuronjësit e krahinavet,të vijën për të uruar statullën. E u mbëjodhën të gjithë bashkë:zotëronjësit e vendit,Parësia,kri- etarët,kaptenjët,gjikjtarët,Plekjësia, zotërit e mëdha ndë pushtetie e gjithë urdhuronjësit e krahinavet,sa t'urojën statullën çë vu rregji Nabukonodosori .

E atié shtuara rrrijën të gjithë përpala statullës. E leçitësi uluriti me një zë të fortë: Juve isht e thuhet,juve, popuj,farë e gluhe. Te hera kur të gjegjij t'i bien zënores,flojerës,kjitharës(tsinganës),zamares,msaltirit,topanit e gjithë atëre llojë musiktare:tek ajo herë gjithë ju të bini përmist tue u falur statullës t'artë çë këtu' vuri shtuara Nabukonodonosori,rregji. E kush mos ngë rafshit përmist t'i falet,tek ajo herë ai ka t'jet shtur te furri me ziarr i diegur. Andai kle se kur popujt gjegjën t'i bijën zënores,flojerës, kjitharës,zamarës,msaltirit,topanit e

ESPERINOI I TË SHTUNIES

e gjithë atire llojé musiktare, ran përmist gjithë popujit, farët e gluhat e ju falën statullës t'artë çë vu atié Nabukodonosori rrekjë. Ahierna tsa burra kaldnjë van'e ngalesën te rregji Judhénjët, tue thënë: rrofshë gjithëmonë, o Rrekjë! Ti, o Rrekjë, keshtur zërin me urdhër, se nga-njeri çë, të gjegjurit çë gjegjet t'i bien zanorës, flojerës, kjitharës, zamarës, nsaltirit, topant e gjithë atire llojé muzikie, mos ngë rafshit përmist tue u falur statullës të artë, ka t'jet shtur te furri i diegur ne ziarr. Janë tsa burra Judhénjë, çë ti ke vënë mbi veprat e krahinës të Babilonës, Sedrahu, Misahu e Abdenagoi të cilët ngë muartin 'veshë urchurimin t'ënt e ata ngë i luten perëndivet t'atë e ngë i falen statullës t'artë çë ti vure. Ahierna Nabukodonosori u trëbua e te mbëria e 'tij i tha t'i sillien përparrë Sedraun, Misahun e Abdenagoin: e i klenë kjellur përparrë Rregjit.

ESPERINOI I TË SHTUNIES

Nabukodonosori mori e i tha atireve: vërteta, se ju, Sedrah, Misah, Abdenagò, n ngë i lutij perëndiravet t'imë, e se ngë i falij statullës çë u vura? Andai ju nani do t'e bëni, se, si të gjeqij t'i bien zënores, flojerës, kjitharës, zamarës, msaltirit, topant e gjithë atire llojé musiktare, ju do t'bini përmist e t'i falij statullës çë u bëra: në mos ngë doni t'i falij, tek ajo herë ka t'jini shtur te furri i nzeht me ziarr. E kush ë Perëndia çë do t'ju shkulnjë 'n duarshit t'ime? E ju përgjegjën Sedrahu, Misahu e Abdenagoi, tue thënë rregjit Nabukodonosor: Ngë i duhet, se na të t'përgjegjemi mbi këtë filalë. Pse isht Perëndia i jinë në kjiell, kuj na i lutemi: Aì mëndë të na shkulnjë nga furri i diegur me ziarr, e Aì do t'na ruanjë, o Rrekjë, nga duart t'o-te. Në mos na ruashit edhé: t'e die Kurora jote, o Rrkjë, se na ngë i lutemi perëndiravet t'atë e na ngë i përmisemi statullës çë ti bëre. Ahierna Nabukodonosori u fri e u tërbua fort, edhé fiti-

- - - ESPERINOI I TË SHTUNIES

ra e fakjes s'tij u ndërrua kundra Sedrahut, Misahut e Abdenagoit e urdhuroi të digjëjen furrin për shtatë herë më shumë se kur dukej i diegur. E i tha tsa burrave të fortë në ushtri të lidiën për këmbëshit Sedrahun, Misahun e Abdenagoin e t'i shtijën brënda furrit të diegur me ziarr. Ahierna ata burra klenë lidhur me gjithë ënterin e brekët e 'tire, ne kësulat e me këputët e me gjithë të veshurat e 'tire; e klenë shtur në mes të furrit të flakët me ziarr. Pse fiala e rregjit po i shtij të bönej shpejt. E furri ishë diegur për shtatë herë më shumë se t'jerë herë: e flaka e ziarrit vrau ata burra çë muar e shtun Sedrahun, Misahun e Abdenagoin. Por këta të tre, Sedrahu Misahu e Abdenagoi ran të lidhurë në mes të furrit çë digjëj: e zun të jitsiën atei e këtei tue lëvduar Perëndin, tue bekuar t'en' Zonë. E Azaria u mba shtuara tue parkalesur kështu': e në nes të ziarrit aì sbilli gojën e'tij

- - - ESPERINOI I TË SHTUNIES

e thëshëj: Bekuar Ti je, o Zot, Perëndia i tatëravet t'anë; e embri i jit ë i lëvduashim e i lëvdëruashim për gjithë monë. Se ti je i drejt mbi gjithkjish na ke bër neve, e veprat t'ote janë të vërteta e të drejta janë udhët t'ote e gjithë gjikjet t'atë janë të vërtetë. E gjikime së vërtetie ti bëre mbë gjithë këto çë na prure neve e mbi Jerosolimin, kjitetin shejt i tatëravet t'anë: pse këto të gjitha ti na i ke dërguar me tërvërtetë e drejtëri mbi ne për mëkatët t'ona: përgë na mëkatruam e lamë ligjën tënde tue rrashur largu ngah Ti e te gjithkjish na të ftesëm; e ngë gjegjëm urdhurimet t'atë: na ngë i ruajtëm e ngë bëm ash-tu' si ti urdhurove, sa edhë të na streksëj mirë. E gjithkjish, sa-do na prure neve, e e gjithë atë çë nabëre neve, ti e bëre ndë gjikim të vërtet: e na

ESPERINOI I TË SHTUNIES

ke dhënë te duart e armikjëvet të paligjë, të kekjë shumë, të palutshmë e te duart e njëi rregji të pa-drejtëri, e më të ligut te gjithëjeta. E nanì ngë mëndë na të sbilliën gojën t'ënë: dhunë e turpëri na nget neve shërbëtorëvet t'atë e të lutshmëvet t'atë.

Mos na lërë gjithëmonë paj t'ëmbrit t'ënt e mos prish dhiatën t'ënde. E mos na ndsir lipisin t'ënde paj t'A-bramit çë Ti deshe mirë, e paj t'Isakut shërbëtorit t'ënt e Israelit shejtit t'ënt: paj t'atëre kuj Ti i fole tue taksur, se ki't'rritej shumë fara e 'tire, sa ijëzit e kjielliës e sa rëra mbë buzë të dejtët. Pse, o Zot, nanì na jemi bër më të pakëtit te gjithë gjindet, e jemi sot të poshtrë te gjith jetë përmëkatët t'ona. E te ki mot ngë kemi na as një Krie, as një Profet, as një Urdhuronjës: na ngë kemi as një flijim, as një gjithëmedie gurshme, as një

ESPERINOI I TË SHTUNIES

të falur, as livan, as një vent edhé ku të biem Tij dhureti të parat pemë të dheut, sa të gjejëm ndëjésë: por me zëmërë të prerë e me shpirt përunjësie na klofshim pritur mirë ngah Ti.

Si kur tue diegur gjithë e deshë e terë e mijëra kjenkjë të majmë, kështuë kloft përpara Tij sot flija jonë e umbaroft Tij e pëlqjieme: se mos të ken dhunë ata çë kanë besën tek Ti. E nanì me gjithë zëmërë na të vijëm prapa e të trëmbemi Tij e körkojëm fakjien t'ënde. Mos të naduash në dhunë, por bën me ne si të thot butësiq jote, lipisia e madhe jote. E Ti na ruan me famasmët t'ote e jipi lëvdì émbrit t'ënt, o Zot. E paçin mbarrie gjithë ata çë i dëftojën të zezat shërbëtorëvet t'atë e klofshin turpëruar nga gjithë pushtetia jote: fukjia e 'tire le t'drämonet. Le të njohiën se Ti je

ESPERINOI I TË SHTUNIES

Zoti Perëndia njëth i vetëm, i lëvdushtë mbi gjithë jetën. E shërbëtorët e rregjit çë i kishën shtur atié brënda, ngë sosiën tue diegur furrin me naftë, ne pitçë, me shtupë e me dru dhrish.

E flaka ngrëhej mbi furrin lartëzë si dizëtë e nëndë kute. E u sgjerua e bë dhrom e dogji ata Kaldenjë çë gjeti rrëth furrit. E Ëngjëlli i Perëndis u sdrip e rrrij bashkë me Azarin e me shokët e 'tij brënda furrit e mbaj largu atireve flakën e ziarrit te furri. E në mes të furrit bë të frij një erë notie: e ziarri ngë i ngisëj ata mosgjë fare, as i helmoi, as i bëri atire gjë të kekjë. Ahierna të tre si gjithë njëi goje ata këndojet e lëvdojet e bekojet Perëndin te furri tue thënë: Bekuar Ti je, o Zot, Perëndia i tatëravet t'anë, i kënduashim e i lartësuashim për gjithë monë: e bekuar embri i shejt i

446.

— ESPERINOI' I TË SHTUNIES

lëvdis t'ende, i kënduashim e i lartësuashim për gjithë monë. Bekuar je Ti te faltoreja jote e lëvdis t'ende të shejte, i kënduashim e i lartësuashim për gjithë monë. Bekuar je Ti çë sheh te më të humbëtitë, Ti çë jes mbi Hjerruvintë, i kënduashim e i lartësuashim për gjithë monë. Bekuar je Ti mbi të ndejturit e kjielliës, i kënduashim e i lartësuashim për gjithë monë. Bekuar je Ti mbi thronin e lëvdis s'rregjëris t'ende, i kënduashim e i lartësuashim për gjithë monë.

KËNKA E TRE DIELMËVET TË SHEJTE (Dan.III,57-88)

Tòv Kúptov ûpveñte...

T'ën'Zonë po lëvdoni edhé po lartësoni Atë për gjithëmonë.
57. T'ën'Zonë po bekonju gjithë veprat e Perëndis.

58.59. T'ën'Zonë po bekonju - ju ëngjëj të Perëndis, ju kjiellia ...

ESPERINOI I TË SHTUNIES

- 60.61. T'ën'Zonë po bekoni - ju ujëra
të gjithë çë jini mbi kjielliat
-ju gjithë
ushtri të Perëndis ...
- 62.63. T'ën'Zonë po bekoniju diell e
hënëzë, ju ijtëze të kjielliës ...
- 64.65. T'ën'Zonë po bekoni - ju shira
dhe laksira, ju erë të gjitha ...
- 66.67. T'ën'Zonë po bekoni -ju ziarr
e të ngrohet, ju tëtim e vapë ...
- 68.69. T'ën'Zonë po bekoçi - ju laksi-
ra e brima, ju akull e të ftohet ...
- 70.71. T'ën'Zonë po bekoni - ju të n
ngrim edhé sborë, ju shkrepëtima edhé
mjegulla ...
- 72.73. T'ën'Zonë po bekoniju dritë e
të nätterrët, ju ditë dhe netë ...
- 74.75.76. T'ën'Zonë po bekoni - ju dhe
male e rehje, ju bëma të gjithë çë le-
hij nga dheu ...

ESPERINOI I TË SHTUNIES

- 77.78.79. T'ën'Zonë po bekoni - ju kro-
nje, ju dejtëra e lume, ju pishkjë të gji-
thë çë livizij te ujërat. T'ën'Zonë ...
- 80.81. T'ën'Zonë po bekoni ju zoga të
gjithë të kjielliës, ju kafsha të gjithë
të egëra edhé të buta. T'ën'Zonë ...
- 82.83. T'ën'Zonë po bekoni - ju bij të
njerëzëvet edhé Israeli. T'ën'Zonë ...
- 84.85. T'ën'Zonë po bekoni - ju Priftë-
ria e Perëndis, ju shërbëtorë të Perën-
dis. T'ën'Zonë ...
- 86.87. T'ën'Zonë po bekoni - ju frima
e shpirtra të të drejtëvet - ju shej-
tra e ju ne zënërën të përujëme T'ën' ...
88. T'ën'Zonë po bekoni - - ju Anani,
Azari, Misaill. T'ën'Zonë po lëvdoni
edhé të lartësoni Atë pér gjithëmonë.
+
- T'ën'Zonë po bekoni, ju Apostoj, ju Pro-
fetra, ju Martëra. T'ën'Zonë ...
- Lëvdi past ... T'ën'Zonë po bekojëm:
Atin, Birin e Shpirtin Shejt. Po lëvdojëm

ESPERINOI I TË SHTUNIES

edhé po lartësojën Atë pér gjithëmonë.

Nanì e gjithëmonë...

T'ën'Zonë po këndojëm, po e lëvdojëm,
edhé i përmisemi, tue lëvduar e tue lar-
tësuar Atë pér gjithëmonë.

*më para se pistulla në vend të
"trisajit" këndonet "Osi i Hriston"...*

O SA NË KRISHT U PAGËZUAT
ME KRISHTIN JU U VESHËT .
(3)

Gjithë dheu le të t'përmiset
Tij e të të msalënëjë.

Këndoni t'in'Zoti me haré:
gjithëjeta.

Rromanëvet VI, 3-11.

Vëllézör , sa u pagëzuam mbë Krishtin,
na u pagëzuam mbë vdekjen e 'Tij. An-
dai ne pagëzimin mbë vdekjen e 'Tij,
na klenë varrëzuar bashkë me Atë;sa
ashtu', si Krishti u ngjall së vdeku-
rish pér lëvdì të të Jatit , ashtu' e-
dhé na jetsiém te një gjellë e re.

450.

ESPERINOI I TË SHTUNIES

Pse nö na u lem bashkë tek Aì mbë të
glarit e vdekjies s'Tij:do t'i jemi ba-
shkë edhe në të ngjallurit . Se e dim
këtë:se njeriu jinë i vietër kle bashkë
ngrikjë sa të shkatarronej kurmi i më-
katës, mos të shërbejën më na mëkatën.

Përçë aì çë ka vdekur ka klënë me të
drejt liruar nga mëkata. E në na vdikjën
me Krishtin, kemi besë se edhé do t'rro-
jëm me Atë. Pse dim se Krishti, posa u
ngre së vdekurish, ngë vdes më, e Vdekja
ngë e zotëron më. Pse tò ket vdekur
Aì, vdikjë pér mëkatën, po një herë vetëm.

E të rronjë, rron Aì pér Perëndin.

Ashtu' edhé ju të ndëlgonij si të vde-
kurë mëkatës, por të gjallë pér Perëndin
tek in'Zot Iisué Krishti.

*në vend të këndonet Aliluja
del Ipeshkëpi nga Vima e tue shtur fletë
dhafnë zhë këndimin e Ms.81: 'Aváora
ð Θεὸς ...*

451

ESPERINOI I TË SHTUNIES

N g r e u , o Perëndi e gjikò jetën,
psc t'otet kanë tö jen gjithë gjindet!

Perëndia u mba ndë mbëledhie pe-
rëndirash:atié në mes t'atire Aì
bën ligjë. Ngreu ...

Njera kur ju do t'gjikoni padrej-
tëri e do t'i ruani fakjen të më-
katruamëvet? Ngreu...

Jipëni ligjë të likështit e të
varfërit:jipëni të drejt të mje-
rit e të urmit. Ngreu ...

Shpëtoni të urmin e të vapëkun:
ju shkulnie 'n dorie të kekjit.

Ata ngë njohiën,ngë kanë ndëlgim:
jetxiën më t'errët. Le të tunden
të gjitha kjëndrat e jetës.

U thash:ju jini perëndira:e të
bijët e të Lartit jini ju të gji-
thë.

ESPERINOI I TË SHTUNIES

Por edhé ju kini të vdisni,si një-
rözë e të bini edhé si një nga Ur-
dhuronjësit.

V a n g j e j i Mt.XXVIII,1-20.

Si shkoi e Shtunia,kur zu të bëj ndri-
tçullë e para ditë e javës (e diellia)
jerdhi Mëria Madalenë e jatëra Mërie sa
të shihiën varrin. E shi' një tundie
e madhe e dheut streksi. se një Ëngjëll
i t'in'Zoti u sdrip nga kjiellia edhé
u kjas e rrrogolisi gurin nga dera e ju
uj sipër. E ishë fitira e 'tij si sh-
kreptimë dhe e veshura e 'tij si sborë.

E pör dren e 4tij u shkundën ata çë ru-
ajën e u bën si të vdekurë. E u përgjekj
ëngjëlli e i tha gravet:mos trëmbij ju,
e di se kërkoni Iisuin çë kle vënë në
krikjë. Ngë ë këtu':se Aì u ngre ashtu'
si tha. Ejani shihëni vendin,teku ishë
vënë Zoti.

ESPERINOI I TË SHTUNIES

E shpejt etsëni e i thoni dsënësëvet e 'Tij, se u ngjall së vdekurish? E shi' se vete përpara juve në Galilé; atié ka t'e shihëni. Shi': ju e thash!

E shpejt dollën nga varri me dre e me gëzim të mathë e rrrodhën. E si ato ish' e vejën të jarrëfiejen dsënësëvet e 'Tij, edhé shi' Iisui i vate përpara tue thënë: Ju falem. E ato u kjasën, i zun këmbët Atij tue përmisur. Ahierna i thot atireve Iisui: mos trëmbij: étsëni rrëfieni t'imë vëllézërve sa të vijën në Galilé e atié ka t'më shohiën. E kur ato vanë, shi': ndonjë nga ruesit çë jerdhën nga kxiteti, t'i rrëfiejen të parëvet e priftravet gjithë atë çë streksi. E u mbëjodhën bashkë me Plekjësin e posa mbajtën këshill, i dhanë ushtarëvet burri 'rrgjëndi, tue thënë: thoni se dsënësit e 'tij jerdhën natën e E vodhën kur na ish'e flëjëm. E në ki shërbes u dsë-

454.

- sh
me
dr
as
sh
ra
va
Ii
ts
ju
në
E
tu
e
sì
dc
g.
je

Σ

ESPERINOI I TË SHTUNIES

shit nga kjivertari, na do t'e bindiën me të fola e ka t'ju bëjën të rrini pa dre. E ata muarrtin 'rrgjëndin e bën aştu' si klenë mësuar. E këjo fialë shkoi n'gojë n'gojë te Judhenjtë njerëza më sot. E të njëmbëdhietitë dsënësë vanë në Galilé te maliku i urdhuroi Iisui e si e pan ju falën përmist, po tsa vetë ishën të ndërdishmë. E Iisui ju kjas e i foli tue thënë: Më kle dhë-në Mua pushtetie në kjiell e mbi dhe.

Etsëni andai e mësoni gjithë gjindet, tue pagëzuar ata mbë émbrin të t'Jatit e të Birit e të Shpirtit Shejt, tue mësuar atireve të ruajën gjithëkëjishë çëdo ju urdhurova. E shi' U jan me ju gjithë ditët njera kur të sosënjejeta. A m i n .

për parkalesit e Meshës s'Shën
Vasijit vërej tek e Intia e Madhe
në vend të "Hjewvikovit" këndonet:
Σιγησάτω πᾶσα σάρξ βροτεία...

----- ESPERINOI i të SHTUNIES

Gëdò mishë të vdekshim le t'rrie pa folë ! Le t'rrie me dre e trëmbësi e mosgjë mendofshit të dheut !

Pse Rregji i rregjeronjësëvet e Zoti i zotëronjësëvet isht e kjaset sa të flijonet e të jipet për ushkjmë të besnëvet. Përpara Atij po vijën gjithë koret e ëngjëjvet, Fukjít e Pushtetiet ne Hjeruvimtë me shumë sira e Serafintë me gjashtë fletë me të cilat pështrojën fakjet e tire e thërrësiën, aliluja.

për "Episihjerin" v. f. 200.

kjinonikoi: U ngre si pas gjumit e u ngjall tue na shpëtuar, aliluja.

në vend të "Idhomen to fos": Kujtou pér ne, o Lipisiar, si u kujtove pér kusarin, te rregjëria e kjielliat. Shën Vasijit: Kjell-folësin i Krishtit, dsënësin i Zotit, illin të ndritshëm, nga Kjesaria e Kapadokëvet hora, Vasijin të mathë të gjithë nderojëm na.

E SHEJTA DHE E MADHIA
E DIELLIË E PASHKËVET

O r t h^ro s

Dhespoti dhes kjàniun te livenistinë e thërrret:

Δεῦτε λάβετε τὸ φῶς ...

Ejani e mirräni drithën e Dritës e pangrisurë. Le t'këndoja jën e të lëvdoja jën, o popuj, Iisuin çë na u ngre së vdeku-rish !

si nisemi t'veni jashta këndoja jën:

Tὴν Ἀνάστασίν σου, Χριστὲ Σωτήρ,
Ἄγγελοι ...

Ngjallien t'ënde, o Krisht Shpëtues, Ëngjëjtit këndoja jën në kjiell e neve mbi dhe bën-na të mirë të T'lëvdoja jën me zëmbrën e pastërë.

Lëvdì past Trinia Shejte,e njëtëklë-nëshme,gjellëberesë,e pa-ndajturë,na-ni e gjithëmonë për jetë të jetëvet.

Diak.: E sajtjemi bërtë mirë të gjegjemi Vangjejin shejt i lutemi t'in'Zoti.

V a n g j e j i Mc.XVI,1-8.

Edhé si shkoi e Shtunia,Mërieja Madalenë e Mërieja e jëma e Jakobit edhé Saloma blen aromët,sa t'vijën e liejën Iisuin. E nenatnet njize tek e para ditë e javës vijën te varri,si doli dielli. E thoshiën ndër 'to:kush mëndë të na ndsierënë gurin nga dera e varrit? E si priren të vërrejën,shohiën se guri ishë rrrogolisur,pse ishë tepër i mathë. E si hirën te varri panjë dialosh i ujur tek e drejta veshur me pethka të bardha e u famasën . Aì i thot atireve:mos trëmbij:ju kërkoni Iisuin Nazarenin çë kle vënë ngrikjë: Aì u ngre;ngë isht këtu':shi' vendi ku e kishën vënë. Por etsëni e thonii dsë-nösëvet e 'tij edhé Pietrit:se Aì vete 458.

përparrë juve në Galilé;atié ka t'e shihëni,si Aì ju tha.

Edhé ato shpejt,si dualltin,jikën nga Varri,pse i kishë narrë dreja,si të llavura. E mosnjeriu i thanë gjë,pse ishën të dreruame.

Si sos Vangjeji Dhespoti tue livanisur këndon:"Lëvdì past Trinia..."çë gjen shkuarë te fakjia më para.

H r i s t ò s a n é s t i ...

Krishti u ngjall! Aì tue vdekur ndridhi vdekjien e shkretë e të vdekurëvet te varret i dha gjellën e vërtetë.

U ngrefshit Perëndia e klofshin shprishurë armikjët e 'Tij,e jikëshin nga fakjia e 'Tij ata çë i kanë mbëri.

Krishti u ngjall!...

Si kamnoi sduket , ashtu' le t'sduken
ata, si dillët jøset pérpara ziarrit,

Krishti u ngjall!...

ashtu' kanë tē humbiön tē mëkatruamit
pérpara Perëndis; e tē drejtit le tē
gëzonen

Krishti u ngjall! ...

Köjò isht dita çë bë in'Zot:le t'gë-
zonemi e tē böjëm haré këtë ditë.

Krishti u ngjall! ...

Lëvdì past ...

Krishti u ngjall! ...

Nanì e gjithëmonë ...

Krishti u ngjall!...

Diak./ en irini

Prifti: Oti prepi

Dhespoti tue kësitur derës:

Ngreni diert t'uaja, ju tē Parë, dhe
ngrëhij, o dier tē përijetshime e dë
t'hinjë Rregji i lëvdës.

brënda Klishës një thërrët e pien:

Kush ë ki Rrekjë i lëvdës ?

- Zot i fort i mëndëshën. Zot mundësor
te lufta. Ngreni diert

Kush ë ki Rrekjë i lëvdës ?

- Zoti i fukjivet: Aì ë Rregji i lëvdës.

*Dhespoti shtin derën e gjithë hijën
tue kënduar:*

Krishti u ngjall! Aì tue vdekur
ndridhi vdekjen e shkretë
e tē vdekurëvet te varret
i dha gjellën e vërtetë!

K A N O N I

'Αναστάσεως ήμέρα ...

Dita e Ngjallies ! Le t'lambarisiën
ne gëzim, o popuj . Pashkët e t'in'Zo-
ti ! P a s h k ö t !

Se Krishti Perëndì, neve çë këndo jën
könkën e riundies, nga mortia na shkoi
te gjellë, ngadheu te kjiellia.

Καθάρθωμεν τὰς αἰσθήσεις ...

Pastrojëm njénjat e do t'sho hiën
nëpër dritës të pakjasurshme të Ngja-
llies Krishtin të shkëlkjenjë e na çë
këndo jën könkën e mundies do t'e gje-
gjemi çë na thot fiellët: Gëzonij!

Oúravon l µèv éπαξίως ...

Le të dëfrenen kjielliat si duhet,
le t'gëzonet dheu, le t'bën jë haidhi
jéta e tërë çë duket e çë sduket: Se
Krishti u ngre , Hareja e pasosme !

462.

Krishti u ngjall! Ai (3)

'Αναστὰς ὁ Ἰησοῦς ἀπὸ τοῦ τάφου...
I ngjallur Isuthi nga Varri
si kishë thënë
na dha neve gjellën e pasosme
e të madhen lipisi.

ODHA e TRETE

Δεῦτε πόμα πίωμεν καινὸν , ;

Ejani pim një të pir të ri
çë ngë buròn nga shkëmbi i shterpt
po nga kroi i pa-prishëris
fukjia e gëzimi jinë.

Nῦν πάντα πεπλήρωται ...

Nani gjithëshka mbushet me dritë
kjielli, dheu e nënshtresat e dheut.
Andai bëft haidhi kriesa e tërfë
Ngjallies s'Krishtit se te këjò ka
kjëndresën.

463.

ΧΘÈÇ ΣΥΝΕΘΑΠΤΩΜΗΝ ΣΟΙ ΧΡΙΣΤÈ...

Djé u varrzova ne Tij,o Krisht,
sot ngrëhem me Tij çë ngjalle.

Me Tij u vura ngrikjë djé,
sot kjéllömë Ti,o Shpëtues,te lëvdia
e rregjörìs t'ënde.

Krishti u ngjall! Aì ...

I ngjallur Isuthi nga ...

Προλαβοῦσαι τὸν ὄρθρον ...

Si grat ne Marien Magdalenë,më parë
se t'bëj ndritçullë,gjetën gurin e
varrit të gorromist,gjegjën t'i thës
shëj Ëngjëlli: kérkoni Atë çë jet në
dritë të pasosme ndër të vdekurit si
njeri? Vërreni pélhurët e Varrit .

Rridhni e lajmëroni jetës si u ngre
in'Zot tuedhënë vdekjie morties,pse
Aì ë i Biri i Perëndis,Aì çë shpëtoi
njerëzin.

ODHA e KATRËTË

'Επὶ τῆς θείας φυλακῆς ...

Le t'jet me ne Profiti Avakum te këjo
ruajtie e hjynushme e na dëftofshit
Ëngjëllin dritëprurës çë me zë çë pret
na that: Sot jerdhi Shpëtimi jetës,pse
si i gjithëmëndëm u ngjall Krishti!

"Ἄρσεν μὲν,ώς διανοῖξαν ...

Si dialë i paralindur çë del nga gjiri
i Virgjërs u duk Krishti. Si njeri
isht kjenkji i kulluam,pa ngjolle,Pash-
kët t'ona: Aì flija e përsosme,pse Pe-
rëndì i vërtét.

'Ως ἐνιαύσιος ἀμυδὸς ...

Si kjenkje njëi viti,Krishti kurora
jonë e bekuame,me-hir flijonet për gjithë
ne. Pashkët çë pastrojën! E përsë-
ri na shkëlkjén i bukur nga Varri DIE-
LLI i drejtësis.

‘Ο Θεοπάτωρ μὲν Δαβίδ...

Gjyshi David përpara Arkës luajti me
gëzim. Na shejti popull i Perëndis,
përpara të vërtetuarit e simbujvet
le t'gëzonemi me gözim hynor pse si
i gjithëmëndëm u ngjall Krishti.
eti kje eti ... Oti agathòs...
ODHA E PESTË

• Ορθόσωμεν ...

Më para se të gdhjet rrin sguarë
tue i falur t'in'Zoti, në vend të Mira-
rit, kënkat t'ona e do t'shohiëm Diel-
lin e drejtësisë Krishtin çë jep gjithë-
ve gjellën.

Τὴν ἄμετρον σου εύσπλαχνίαν ...

Robët të mbajturë me vargje në Adhë
pan lipisën t'ënde e pamaturshme e jer-
dhën ata nga Drita me könbë e gjuzuamë
tue bër harë Pashkëvet të pasosme.

Προσέλθωμεν λαμπαδηφόροι...

Me llëmpët në dorë veni të përpieki-
ën Krishtin çë del nga Varri si një
Dhëndërr e bëjën haidhì të gjithë bash-

kë Pashkëvet shpëtuesë të t'in'Zoti.

ODHA e GJASHTËTË

Katqllëthësë ...

U sdripe te nënshtresat e dheut e
çajtë vargjet çë mbajën lidhurë robët,
o Krisht. E pas tri ditë, si Jona nga
pishku, u ngreve nga varri.

Φυλάξας ...

Tue ruajtur pa të çarë vulet, dolle
nga Varri, Ti çë gjirin e Virgjërës
le i pangar kur leve, e sbille për ne
dierët e Parraisit.

Σῶτερ μου ...

O Shpëtuesi jim, flijë e gjallë, çë
Ti vet u fale t'it'Eti me-hir, tue u
ngrëjtur nga varri, ngjalle bashkë ji-
nën e Adhamit.

Krishti u ngjall!...

I ngjallur Isuthi...
eti kje eti... Si gar i o Vasilevs...

Kondakjion: Ei nai ëv tάφφ ...
Ti në varrë u sdripe, o i pavdekshim,
po e munde pushtetin e Pisës, e u ngja-
lle si mundësor, o Krisht Perëndi, gravet
mirëprurëse tue thënë:gëzonij; e Apos-
tojet t'atë tue dhuruar pakjen, o Ti
çë jep të rarëvet ngjallien.

O OIKOS

Tue kërkuar Diellin, më para se diel-
li, i çili kishë perënduar "një herë"
në varrë, Miroforët arrun më para se
të bëj ndritçullë si ata kuj i merr
malli për ditën. E ndër 'to thoshiën:
o mike, ejani e liejën me vaj érësh
Kurnin Gjellëdhënës e Atij çë varrë-
zuar këtu! ngrën Adhamin të rar. Bë-
jën shpejt, vemi si Magjinjtë e i
përmisemi e i faliëm Atij aromët, Atij
çë ngë ë pështiellë te skutinat, po te
pëlhura. E me lotë po thomii: Ngreu, o
Zot, Ti çë jep të rarëvet ngjallien.

TEK E SHEJTA DHE E MADHE E DIELLIË
E P A S H K È V E T
KREMTOJËM TË GJELLËDHËNËSE NGJALLIEL
E T'IN'ZOTI PERËNDI E SHELBUESI JINË
IISU' KRISHTI .

Krishti tue u sdripur posht
vetëm të luftoj me Adhin, jerdhi
jashta përsëri e pruri shumë pla-
çka mundie.

Atij lëvdia e pushteti
mbë jetë të jetëvet, amìn .

'Aváστασιν Χριστóυ Θεασάμενοι...

Nanë çë pan të ngjallurit e Krishtit,
le t'i përmisemi t'in'Zoti, Isuthit, të
vetmit të pamëkatë.

Proskjinisiëm Krikjien t'ende, o Krisht,
e Ngjallien t'ende të shejte himno-
jën e lëvdojëm. Se Ti je Perëndia jinë,

ngë njehiën na t'jatër veç Teje e ém-brin t'ënt na thérresiën. Ejani ju gji-thë të besmë, le t'i përmisemi Ngjallies s'shejte të Krishtit. Pse pr'anë të Krikjies erdhi hareja te gjithë jeta.

Tue bekuar gjithëmonë t'ën'Zonë, lëv-dojëm Ngjallien e 'Tij. Pse, tue duruar Krikjien për në, me vdekjen e 'Tij shkeli mortien .

Krishti u ngjall! ...
I ngjallur Isuthi...

ODHA e SHTATËTË

'O Πατέας ἐν ναυτικού ...
Aì çë liroi djentë nga fürri bër njeri vuani si i vdekshën e tue vuajtur naturën e vdekshme e veshë me të shkëlkjierit e paprishëris, i Vetmi i bekuam, Perëndia i lëvduashën i Atëravet t'anë.

470.

Τυναῖνες μετὰ μύρων ...

Grat të urta të rrodhën prapa me aro-mët. Atë çë ato kërkojën me lotë ndërtë vdekuritë, me haré E proskjinisiën si Perëndi i gjallë e dsënësëvet t'atë, o Krisht, lajmëruan këto Pashkë mistike.

Θανάτου ἀπόταξομεν ...

Të morties krentojën vdekjen, të A-dhit prishien, të zënit fill e njëi gjellie e re, e pasosme e me gjëzin lëvdo-jën Atë çë gjithë këto bëri, të Vetëmin të Bekuan, Perëndia i Atëravet t'anë.

‘Ως ζύντως ...

Vërteta e shejte, haidhiare këjò natë dritie e shpëtimi çë na kjah te dita e lambarisme e Ngjallies tek e çila Drita e pamotshme buroi, në kurm, nga Varrë, tue na ndritur të gjithë .

Krishti u ngjall...
I ngjallur Isuthi ...
eti kje eti... Ii to kratos...

471.

ODHA e TETÉTË

AÜRË n̄ ñuérpa ...

Köjò ë Dita e thirrurë dhe e shejte
Dita NJË e javëvet
Mbretëresha e kremitievet dhe Zonja
Panijir i panijirëvet tek e çila
bekojën Krishtin pör mot monë.
Δεῦτε τοῦ καίνοῦ...

Te Dita e lume e Ngjallies
narriën piesë te pena e re e Dhris,
narriën piesë te hareja e hjynushme,
te Rregjëria e Krishtit, tue kënduar
Atë si Perëndi pör mot monë.

"Aporu núnλω ...

Ngre sit rrëth e rrrotull SION e
vërrej:shi' jerdhën bijët t'atë çë
shkëlkjéjn si ijëze me drithë e hjy-
nushme nga Perëndimi e nga Veriu,
nga dejti e nga Lindia e bekojën tek
ti, Krishtin pör mot monë.

i
m
t
n

€
I

Πάτερ παντούράτωρ ...

Ati i gjithëmëndën e Fiala e Shpirti
i Shejt, të tri Vetë një naturë e vë-
me gjithënjëklënëshme dhe e hjynushme,
tek Ti na u pagëzuam e të bekojën pér
mot monë.

Krishti u ngjall! Ai ...
I ngjallur Isuthi

eti kje eti ... Oti evlòjite ...

Diak.: MËMËN e Perëndis e të Dritës,
tue nderuar me himne, madhërojën !

ODHA e NËNDËTË

Madhërò, shpirti jin, Kë ne-hir
vuajti e pas tri ditë u ngre nga
Varri.

Φωτίζου, φωτίζου ...

Ndritu, Ti Jerusalim e re, po ndritu!
Pse lëvdia e t'in' Zoti mbi Tij u dëftua.
Bëj harë e nani gëzou, Sion .
E Ti e dëlirë, Mëma e Perëndis, bëj hai-
dhì te të ngjallurit e Birit t'ënt!

Madhérò, shpirti jim, Krishtin
Gjellëdhënësin çë pas tri di-
të u ngre nga Varri.

Ndritu, Ti Jerusalim e re ...

Krishti Pashkët të reja, Fli-
ja e gjallë, i Biri i Perëndis
çë ndsier mëkatën e jetës.

Ω θελας, ω φιλης

O zë i ëmbël, i hjynushën, vërteta
mik çë na tha se Ti, o Krisht, ka
t'kjëndrosh me ne njer'në mbarim të
jetëvet. Tue pasur këtë shpresë, na
bëjëm haidhi.

Sot gjithë kriesa gözonet e
bën haré se Krishti u ngjall
e Adhi kle dçeshur.

O zë i ëmbël ...

Lëvdì Madhérò, shpirti jim, pushtetin e Hjynis në tre Vetë të
pandarshme.

E x a p o s t. Σαριν ὑπνώσας ...

Si njeri u kjëllove gjumi, o Rrekjë
e o Zot; u ngjalle tri ditëshën e
ngrëjte Adhamin nga prishia e shtipe
mortien. Pashkë të paprishes, Shpëtimi
i jetës! (3)

E N I v.f.31.

Lëvdoni t'ün' Zonë për famas-
nët e 'Tij; lëvdonie për sa i
mathë isht Ai.

Ὑμνοῦμεν σου, Χριστὲ ...

Të këndo jëm, o Krisht, pesimet shpëtim-
tarë e të lëvdo jëm Ngjallien.

Lëvdonie me zë trumbetie; lëv-
donie me msaltirin e kjitharën.

Ο σταυρὸν ὑπομείνας ...

Ti çë durove Krikjien e prishe morti-
en e u ngjalle së vdekurish, si i vetëm
i gjithëmëndëm jip pakje gjellës t'ë-
në.

S t i h j i r à tē Pashkëvet

Lëvdonie me timpan e me vallë;
lëvdonie me lahutë e organ.
O ròv "Ἄδην ...

O Krisht, çë munde Adhin e ngjalle nje-
riun me tē ngjallurit t'atë, bën-na tē
mirë me zémërë e pastërë tē T'këndojet.

Lëvdonie me kjinvale me tin
gull i èmbël; lëvdonie me kjin-
vale me tingull i lart.
Tὴν θεοπρεπῆ ...

Tē pérunjurit t'atë tē hjynushëm tue
lëvduar, këndojet Tij, o Krisht !

U leve nga Virgjëra e i pa-ndarshëm
mbet me Atin. Vuajte si njeri e me-hir
durove Krikjien. U ngreve nga Varri
sikurse tue dal nga Nusërorëja, sa tē
shpëtoje jetën. O i Madh'in'Zot, paçë
lövdì !

U ngrëfshit Perëndia e klofshin
shprishurë armikjët e 'Tij, e ji-
këshin nga fakjia e 'Tij ata çë
i kanë mbëri.

Πάσχα τ'ερὸν ...

Pashkë tē hjynushme na u dëftuan ne-
ve sot; Pashkë tē reja e tē shejte; Pa-
shkë mistike; Pashkë gjithë tē ndersh-
ne; Pashkë, Krishti Shpërbленjës; Pashkë
tē thiella; Pashkë tē mëdha; Pashkë e
tē besmëvet; Pashkë çë na sbillën diert
e Parraisit; Pashkë çë shejtërojën tē
besmitë.

Si kamnoi sduket, ashtu' le tē
sduken ata, si dillët joset pér-
para ziarrit,
Δεῦτε ἀπὸ θέας ...

Ejani ju çë e kini par, o gra ; eja-
ni t'ja thoni edhé Sionit. Prite ti
ngak na nduhtën e harés tē Ngjallies
478.

s'Krishtit;gëzou,bëj haré edhé dëfreu,
o Jerusalim,tue par Krishtin Rrekjö,çë
si dhöndërr nga varri ngröhët.

ashtu' kanë të humbiën të mëka-
truamit pörpara Perëndis e të drejtítë
le t'gëzonen..

At μυροφόροι γυναῖκες ...

Grat mirëprurëse menatnet njize tue
kjündruar nd'anëzë varrit të Gjellëdhë-
nësit gjetën Ëngjëllin ujur mbi gurin
e tue folë aì atireve kështu' i tho -
shøj:si ju kërkoni të gjallin bashkë
me të vdekuritë ? Përcë vajtoni të pa-
vdekshmin ? Jetsni e thonii dsënësëvet
e 'Tij:Krishti u ngjall së vdekurish!

Këjò isht dita që bë in'Zot:
le të gëzonemi e të bëjën haré
këtë ditë.

Pásoxa rò τερπνόν ...

Pashkë të güuashme:Pashkë të t'in'Eoti,Pashkë. Pashkë gjithë të ndershme
na u dëftuan neve sot;Paskë në gëzim:
të duheni mirë njeri me t'jetrin. O

Pashkë shpérblin helmi,se nga varri si
nga gjuni u ngre tue lambarisur Krish-
ti,gëzpi grat ne shunë gëzin tue thë-
në: jipëni nduhtën Apostojvet.

dhoksa ... kje nin ...

'Avaστάσεως ἡμέρα ...

Dita e Ngjallies,të jeni të ndriturë
nga festa e të duheni mirë njeri ne
t'jetrin;thomi,o vëllezër,edhé atireve
çë na duan likë:të ndëjëjën të gjitha
te dita o Ngjallies e kështu' të tho-
ni: Krishti u ngjall ! Aì tue vdekur,
ndridhi vdekjen e shkretë e të vde-
kurëvet te varret i dha gjellën e vër-
tetë.

LIGJËRATA E SHËN JANIT GOJART

Nga i besën çë do mirë t'en'Zonë,tra-
zhgofshit sot këtë ditë të krëntie e
bukurë dhe e lambarisme.

Nga shërbëtar i urt le të hinjë sot
në haré të Zotit t'Tij.

Kush-do duroi t'argjëroj,paçit nanë

dënarin. Kush-do shörbeu çë tek e para orë, marshit sočrrogön çë i nget. Kush-do jerdhi pas të tretës orë, sot ne gëzim le t'krentonjë tue u falur nderies.

Kush-do arruri pas të gjashtës orë, nos paçit ndërdie, pse edhé aì ngë do t'ket dën. Kush-do u lips njera tek e nëndëta orë le t'kjaset pa dre. Kush-do jerdhi vetëm tek e njënbëdhietëta orë, mos të trëmbet se mënoi, e mos të psherëtinjë, pse i Zoti ne zëmërë të madhe isht e pret të sprasmin ashtu si të parin.

Ai do t'gëzonjë atë të njënbëdhietëtës orë, ashtu' si atë çë shörbeu çë tek e parë orë. E ka lipisi pér të sprasmin edhé ndér të parin. Këtij i jep, atij i dhuron. E merr punën e përet mirë edhé zënbrën. Ndér të bënen edhé lëvdon mendimin. Andai ejani e hini të gjithë në haré të Zotit t'ënë; e të parë e të dijtë ejani mirrëni rrogën. Të kjosmë edhé të vapkjë bëni vallë gjithë bashkë. Kus u mba e kush ngë u mba, të gjithë nderni këtë ditë. Kus argjëroi e kush ngë argjëroi, bëni sot haidhì.

Ë shtruarë triesa, ejani gjithë të hanë. Viçi isht i mathë: mosnjeri dalshit pa ngrënë; të gjithë trazhgoni triesën e besës. Të gjithë mirrëni nga kjosmët e mirësis, mosnjeri të klanjë i urm, pse na u dëftua gjithëve rregjëria; mosnjeri vajtofshit fajet, pse nga varri jerdhi ndëjesa; mosnjeri u trënbshit vdekjies, pse vdekjia e Liruesit, e Shpëtuesit na liroi. Aì i mbëjedhur nga vdekjia, mundi vdekjen. U sdrip te Pisa e reshti Pisën. Iisu Krishti Perëndi na shpëtoi e na liroi nga Pisa. E Pisa u helmua si ngau Kurmin shejt e t'Zotit, ashtu' si kishë thënë Isaia: "Pisa u helmua si të përpokji atié posht. U helmua pse kjëndroi pa pushtetie; u helmua përcë edhé kle kjeshuar; u helmua përcë edhé kle sosur; u helmua përcë edhé përfaruar; u helmua përcë edhé kle lidhur .

Prandai mënd't' thom: ku isht, o vdekjie, fukjia jote? Ku isht, o pisë, mëndia jote? Krishti u ngre e ti u gorromise! Krishti u ngre, e diajit ran përmist! Krishti u ngjall e ëngjëjit u gë-

zuan! Krishti u ngjall e gjella u përtëri! Krishti u ngjah e të vdekurit u ngrëjtën bashkë me Atë! Krishti u ngjah e na shkaptuam nëmën! Krishti u ngre e na u ngrëjtëm me Atë! Krishti u ngjall e na patëm gjellë!

Krishti i ngjallur së vdekurish lëvdi past nani e për gjithë monë Ashtu'kloft.

Shën Janit Gojart: Si një flakë e ndriti jetën e tërë tue shkëlkjier ai hir i gojës s'ate,o i shen Jan Gojarti, ajo gojë që la vistare e dorëgjerësis,e na dëftoi të lartit e përunjësis tue na mësuar me fialët t'ote: lutu për ne Iisu' Krishtit Perëndì sa t'jen shelbuar shpirtrat t'anë.

Krishti u ngjall!
Vërteta u ngjall !
Rron e rregjeron
për gjithë monë .

+

NDREKJË GABIMET :

F.	rr.	SI ISHT	SI KA T!JET
15	2	dhiatë	dhiatën
21	18	so	sot
,	20	vata	vate
34	17	pësiellmie	përsiellmie
40	10	-	sa
41	8	oemë	pemë
42	8	ta	meta
49	18	shuësuarit	shumësuarit
55	15	pathëshme	pathënëshme
56	3	bënda	brënda
62	2	Teja	Teje
,	sprasmi	si	sit
67	11	mi	mirë-
94	spr.	rë	të
95	parasdr.	aié	atié
10	12-13	urrejyi	urrejti
,	9	klënë -	klënë e ndohtë
,	10		
,	15	viajën	vuajën
106	13	'yij	'tij
110	5	GRUAJA	GRUAN
111	6	pëbuzën	përbuzën
121	23	duar	duart
127	10	di	si
131	3	mohish	mohosh

F	rr	SI ISHT	SI KA T!JET
135	13	lajti	lajte
136	15	jata	jeta
143	20	i pandëgje...	i pandërgje...
146	9	përgatoten	përgatiten
160	19	mëdja	mëdha
177	16	varsni	varesni
180	13	E si sih'e	e si ish'e
196	spr.	gji-	gjith-
199	10	gjakur	gjakut
207	20	u kundua	u kungua
214	4	urdhuril	urdhurim
215	14	rdhé	edhé
222	16	Përgëzoni	Përgëzori
225	8	t'ini	t'im
230	14	njenjat	ndenjat
243	1	çë isht të	çë isht çë
246	2	njihrsh	njiresh
247	1	zëmëmath	zëmërëmathë
,	2	i panjohur...	të panjohur...
252	9	Pilata	Pilati
,	17	sihë	ishë
262	20	mo	mori
272	10-11	ti Krishtij	Tij Krishtin
,	12	thoëi	thomëji

F	rr	SI	ISHT	SI KA T'JET
304	1	na		nga
307	20	so		si
310	5	milliën		mbilliön
318	2	shtijyë		shtijtëñ
319	6	kallë		kallëm
322	6-7	hijtë		hijtëñ
,	12	Perëndia		Perëndie
328	8	u shkun		u shkunt
331	11	thèrrin		thèrrini
335	6	fshihia		fshihie
346	5	vërrëzon		varrëzon
356	n.58	në krie		në krikje
360	n.5	leve		leva
,	n.6	Atij		Atin
365	n.37	kjindati		kjindari
372	spr.	leve		leva
375	1	li-		lipi-
385	4	ngrishurë		ngridhurë
,	spr.	drjtité		drejtité
389	12	kekjat		të kekjat
392	16	tek		tek Ajò

F.	rr.	SI	ISHT	SI KA T'JET
405	2	baku		barku
,	15	gjelle		gjella
408	5	ke -		kekjë
409	paraspr.	fuashat		fushat
410	4	ha-		haj
411	18	that		thet
415	13	hijtë		hijtëñ
428	6	du		dua
430	14	gëzie		gëzim
			+	